



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 157 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), të nenit 84 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 8/01 janar 2007), nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurë për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës për leje përdorimi nr. 05-391/04-303431/19/1 dt. 30.12.2018, të Isak Reka, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me datë 14.01.2020 merr këtë:

V E N D I M
I LEJES SË PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarit Isak Reka, nga Prishtina, Lagja, përdorimi i lokalit afarist me sipërfaqe prej 71.80 m², cili ndodhet në ndërtesën banesore në Lagjen Qendra, rruga “Fehmi Agani” b/48 nr.2 në Prishtinë i shndërruar nga banesa në afarizëm sipas Aktvendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit 05 Nr. 351-13508, dt. 16.10.2005, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

II. Ndërtesa do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi nga pika I. dhe dokumentacionit teknik.

III. Njësia nga pika I. e këtij Vendimi mund të përdoret dhe shfrytëzohet nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktvendimi.

IV. Ky Vendim do të shërbejë si bazë për regjistrimin e njësisë të përshkruar në pikën I. të këtij Vendimi në evidencat kadastrale.

A r s y e t i m

Pronari, Adem Kozmaqi, me kërkesën me nr. 05-351/04-303431/19/1 dt. 31.12.2019 i është drejtuar kësaj Drejtorie për përdorim të lokalit afarist i cili ndodhet në kuadër të ndërtesës shumë banesore në Lagjen Qendra 1, rruga “Luan Haradinaj” nr.29 në Prishtinë i shndërruar nga banesa në afarizëm sipas Aktvendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit 05 Nr. 351-367, dt. 29.11.2002, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar:

- Procesverbalin mbi kontrollimin teknik të objektit investuese nga komisioni profesional i emëruar nga kjo Drejtori sipas Vendimit nr. 05 Nr. 351/04-0161861/18 dt. 16.08.2018.
- Dokumentacionin përcjellës, kopjen e planit, certifikatën e njësisë kadastrale, atestet e materialeve, certifikatat, etj.

Me vendimin nr. 05 Nr. 351/04-303431/19 dt. 18.18.2019 është emëruar Komisioni për pranimin teknik të lokalit në përbërje prej pesë antarëve. Komisioni ka filluar punën menjëherë, ku secili prej antarëve ka hartuar raport individual. Në raportin e komisionit për pranimin teknik të objektit është theksuar se gjatë realizimit nuk janë bërë ndryshime nga projekti i apriovuar me leje ndërtimi.


Njëkohësisht është konstatuar se objekti investues është ndërtuar në pajtim me vendimet e cekura më lartë dhe dokumentacionin tjetër teknik dhe se i njëjti përmbushë normativat dhe standardet, aplikimi i të cilave është i domosdoshëm me rastin e ndërtimit të objekteve të tilla, për çka edhe ka propozuar që Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, t'i lëshoj lejen e përdorimit, andaj kjo Drejtori vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendimi mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësim nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet të organi epror-MMPH-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve, Drejtorisë së Kadastrit, Qendrës për shërbim me qytetar, kësaj Drejtorie dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 Nr. 391/04-303431/19/1 Dt. 14.01.2020

Zyrtari:
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi

